



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të asetëve, të përfshira në markën “Ace”, nga shoqëria The Procter & Gamle tek shoqëria Fater Sp.a

Në datën 27 Shkurt 2014, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshje Shit-Blerje Asetesh”, të nënshkruar ndërmjet palëve (“Fater S.p.a” në cilësinë e **blerësit** dhe “The Procter & Gamble” në cilësinë e **shitësit** dhe shoqërisë italiane Tentimetri Angelini) më datë 18 Shkurt 2014, me objekt transferimin e biznesit që përbëhet nga asete të përdorura për prodhimin, paketimin, shpërndarjen, promovimin dhe shitjen e produkteve të kujdesit për rrobat, të përfshira në markën “Ace” në cilësinë e biznesit Target nga shoqëria The Proctel & Gamble tek shoqëria Fater S.p.a.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- **The Procter & Gamle:** është shoqëria mëmë e Grupit ndërkombëtar “P&G” dhe ushtron veprimtarinë kryesisht në fushën e prodhimit të produkteve të përkujdesjes për shtëpinë dhe rrobat, produktet kozmetike, produkte të kujdesit personal, të përkujdesjes për shëndetin, për fëmijet dhe familjen;
- **Ace:** (ose biznesi target) përbëhet nga asetet e përdorura për prodhimin, paketimin dhe shpërndarjen, promovimin dhe shitjen e produkteve për kujdesin ndaj rrobave në vende të ndryshme Europës Qendrore dhe Lindore, Azisë Qendrore dhe Afrikës;
- **Fater Sp.a:** është një shoqëri ndërkombëtare e cila është aktive kryesisht në prodhimin dhe shitjen e pelenave, produkteve të inkontincencës dhe pecetave sanitare.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b) dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**